



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 AGENCIA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. DPKPP
 Broj stranica 03

Nr. Prot. 03-03/1192/18
 Prati
 Data 19.04.2018

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

| | |
|------------------------|--|
| DATË/A: | 19.04.2018 |
| REFERENC-Ë: | AKK- DPKPP /03-03-1181/18 |
| PËR/ZA/TO: | z. Feti IBISHI, Menaxher i Zyrës së Prokurimit- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale |
| CC: | z. Izedin BYTYQI, Sekretar i Përgjithshëm – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale |
| NGA/OD/FROM: | Shaip HAVOLLI, Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Opinion lidhur me Tenderin me titull: “Ofrimi i shërbimeve të bufesë për objektin e MPMS-së dhe për APRK” me nr. të prokurimit 209/18/2348/221, nr. të brendshëm 209/18/015/221. |

I nderuari z. Ibishi,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin: “Ofrimi i shërbimeve të bufesë për objektin e MPMS-së dhe për APRK” me nr. të prokurimit 209/18/2348/221, nr. të brendshëm 209/18/015/221, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerri të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin: **“Ofrimi i shërbimeve të bufesë për objektin e MPMS-së dhe për APRK”** me nr. të prokurimit 209/18/2348/221, nr. të brendshëm 209/18/015/221, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

Arsy etimi

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Agjencia), me datë 13.04.2018, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: *AKK-03-03-1181/18*, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull **“Ofrimi i shërbimeve të bufesë për objektin e MPMS-së dhe për APRK”** me nr. të prokurimit 209/18/2348/221, nr. të brendshëm 209/18/015/221, i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma **E-Prokurimi** ka analizuar njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe pjesën e specifikimeve teknike, ku ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurën e hapur, kontratë publike kornizë 24 muaj, të llojit shërbime, me vlerë të mesme të parashikuar 38,500.00€.

Agjencia, pasi ka analizuar me kujdes njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit ka vërejtur se tek neni **III.2.4. Kapacitetet teknike dhe profesionale tek kërkesa 2**, autoriteti kontraktues ka kërkuar që operatori ekonomik duhet të ketë minimum 3 (tre) punëtor, 1 (një) shankisë dhe 2 (dy) kamarier për objektin qëndror në MPMS-së, ndërsa për objektin e APRK-së 2 (dy) punëtor, 1 (një) kamarier dhe 1 (një) shankist. **(Vetëm për fituesin)**. Kërkesë kjo për të cilën Agjencia konsideron se është në kundërshtim me nenin 51 paragrafin 1 të Ligjit në fuqi për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

Sipas Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik më saktësisht në **nenin 51 paragrafi 1** “Autoriteti kontraktues duhet të theksojë në njoftimin e kontratës dhe të përcaktojë në tërësi në dosjen e tenderit të gjitha kriteret e përzgjedhjes që një operator i interesuar ekonomik duhet ti përmbushë për tu konsideruar si i kualifikuar: (i) në rast të procedurave të hapura dhe procedurave të kuotimit të çmimit për dhënien e një kontrate; ose (ii) në rast të procedurave të kufizuara ose procedurave konkurruese me negociata, për të pranuar një ftesë për tenderim. Të gjitha kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në kriteret e nevojshme për të siguruar se vetëm operatorët ekonomik që posedojnë aftësitë e nevojshme profesionale, financiare dhe teknike për të përmbushur kushtet e kontratës përkatëse do të konsiderohen të kualifikuar për të marrë një kontratë të tillë ose për marrjen e ftesës për tenderim. Në asnjë rast, autoriteti kontraktues nuk duhet që të përfshijë, saktësojë ose përdorë kritere të përzgjedhjes që bazohen në konsiderata të tjera përveç atyre të lejuara nga dispozitat e neneve 65-70 të këtij ligji.

Bazuar në këtë Ligj kërkesa për aftësit teknike dhe profesionale janë kërkesa minimale për kualifikim që një operator ekonomik duhet ti plotësoj për tu konsideruar për dhënie të kontratës, respektivisht janë kërkesa të vlerësimit kalon apo nuk kalon një operator ekonomik, nga kjo rezulton se autoriteti kontraktues në rastin konkret ka vepruar në kundërshtim me nenin 51 të LPP-së, duke kërkuar që kërkesa 2 te Kapaciteti teknike dhe profesionale është obligative për kompanin fituese para nënshkrimit të kontratës.

Nenin 26 paragrafi 8 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimi Publik, parasheh se cilat vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë (përveç Deklaratës nën Betim) do të kërkojnë të dorëzohen nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shpërblej me kontratë. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues, konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo-diskriminimi, nenin 27 Dosja e Tenderit dhe nenin 51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe për përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar Operatorët të cilët e kanë tërhequr dosjen e këtij tenderi.

Po ashtu ju njoftojmë se lidhur me këto të gjetura do të njoftohet Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !